

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2017

1.1. Operacione të tregut të hapur

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë¹.) Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj
12.1.17		20,450.00	
19.1.17		24,860.00	
24.1.17			4,000.00
26.1.17		26,300.00	
2.2.17		22,040.00	
3.2.17	1,500.00		
9.2.17		17,900.00	
16.2.17		26,300.00	
23.2.17		20,690.00	
24.2.17			3,000.00
2.3.17		21,600.00	
9.3.17		23,660.00	
16.3.17		26,300.00	
23.3.17	1,400.00	21,700.00	
24.3.17			3,000.00
30.3.17		18,100.00	

Në tremujorin e parë të vitit 2017, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistojnë në operacionet e tregut të hapur dhe veprimet me qëllim administrimin e portofolit të saj të bonove të thesarit.

Krahasuar me tremujorin e fundit 2016, këtë tremujor, nevoja e sistemit bankar për likuiditet u reduktua me rreth 1 miliardë lekë, duke u injektuar në total mesatarisht 30² miliardë lekë.

Në funksion të operacioneve të tregut të hapur, Banka e Shqipërisë ka përdorur instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, për injektim të përkohshëm të likuiditetit për

mesatarisht 20.9 miliardë lekë kundrejt 23.6 miliardë lekëve në tremujorin e katërt të 2016-ës. Por, me qëllim menaxhimin më të mirë të likuiditetit të sistemit, gjatë kësaj periudhe u rinovuan injektimet e gjata për shumën më të lartë, për mesatarisht 9.4 miliardë lekë kundrejt 6.5 miliardë lekëve gjatë tremujorit të mëparshëm.


Operacioni rregullues për injektim njëditor është përdorur në 2 raste për 1.4-1.5 miliardë lekë, për të akomoduar nevojën e bankave për likuiditet në fund të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar në muajin mars.

¹ Shifrat janë në vlerë nominale.

² Shifrat janë në vlerë likuiditeti.

Me synim administrimin e portofolit të saj, Banka e Shqipërisë ka kryer blerje të përhershme të bonove të thesarit 12-mujore dhe maturime të bonove të thesarit 6-mujore në tregun sekondar me rezultat neto rënien e portofolit me 0.745 miliardë lekë kundrejt nivelit të portofolit në fund të 2016-ës.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në vitin 2016-2017 (me vlerë nominale).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur në mënyrë konstante për shumat 1.7-6.7 miliardë lekë, me tendencë rënëse drejt fundit të periudhës deri në 4 miliardë lekë. Ndërkohë, kredia njëditore është përdorur në vetëm 3 raste në ditët e fundit të periudhës së RD-së kundrejt 7 rasteve gjatë tremujorit të mëparshëm, me shumën nga 0.08-3 miliardë lekë në 0.8-2.7 miliardë lekë.


2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË PARË TË VITIT 2017

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në datën 4 janar 2017, Banka e Shqipërisë ka publikuar kalendarin e blerjes së valutës gjatë vitit 2017 në përputhje me vendimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare të datës 28.12.2016 për të blerë valutë nga bankat e nivelit të dytë me objektiv rritjen e rezervës valutore. Më poshtë paraqitet kalendarin e blerjeve për vitin 2017.

Data	Shuma (mio EUR)
10 Prill	3-8
11 Qershor	3-8
20 Korrik	3-8
11 Gusht	3-8
20 Tetor	3-8
17 Nentor	3-8
15 Dhjetor	3-8

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e parë të vitit 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Në tremujorin e parë të vitit kanë vazhduar të lidhen marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekut midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, sipas kërkesave të kësaj të fundit, që synojnë menaxhimin e likuiditetit të saj nëpërmjet investimit pranë BSH-së të tepërave në valutë. Në fund të tremujorit të parë të vitit 2017, shumat e marrëveshjeve *swap* qenë 190 milionë euro dhe 50 milionë SDR, në nivel pak më të ulët se fundi i tremujorit të katërt, kur ato qenë 230 milionë euro dhe 30 milionë SDR. Maturimet e marrëveshjeve *swap* kanë rënë në 1-2.5 muaj kundrejt 2.0-2.5 muajve një tremujor më parë, por janë më të larta se maturimet e zakonshme prej rreth 1 muaji.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2017

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja qenë gjithsej 20.00 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD).

Tabelë 2: Veprime valutore me institucione të tjera

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	20.55	
TË TJERA (IDA, IBRD)	20.00	

Burimi: Banka e Shqipërisë.